



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 344/2017

Nr.i fol./Br.str./Nr.pg. 06/03/17

Data/Datum/Date: 06/03/17



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 6 mars 2017

RAPORT ME REKOMANDIME
I
**MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS I
AVOKATIT TË POPULLIT**

lidhur me vizitën në

**QENDRËN PËR INTEGRIM DHE REHABILITIM TË SËMURVE KRONIK
PSIKIATRIK NË SHTIME**

- Për:
- Z. Imet Rahmani, ministër
Ministria e Shëndetësisë
- Z. Curr Gjocaj, Drejtor i Përgjithshëm
Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
- Z. Miftar Zeneli, drejtor
Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e
të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime
- Z. Naim Ismajli, kryetar
Komuna e Shtimes
- Kopja për:
- Znj. Lirije Kajtazi, kryetare
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Peticione dhe Personat e Pagjetur

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit ka vizituar Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime (QIRSKP).

Datat e vizitës dhe përbërja e grupit monitorues

1. Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejmë “MKPT”) i Avokatit të Popullit më 26 qershor 2016 dhe 13 dhjetor 2016, ka vizituar Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime (në tekstin e mëtejmë “QIRSKP”). Grupi monitorues përbëhej nga një juristë, një mjeke dhe një psikologe.

Historik i shkurtër i institucionit

2. Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime (QIRSKP), si Institucion është në kuadër të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), e cila ofron shërbime 24 orë. Është themeluar në vitin 2006, me 3270m², me 4 reparte (A1-A4) ku janë gjithsej 48 dhoma, me kapacitet deri në 80 shtretër.

Përshkrimi i përgjithshëm i institucionit

3. QIRSKP është institucion i tipit të hapur, rezidentët në këtë Qendër ishin kryesisht të diagnostikuar me çrrëgullime psikotike, si *Schizophrenia*. Gjithsej ishin 63 rezidentë prej tyre 36 të gjinisë mashkulllore, 27 të gjinisë femërore, mosha mesatare sillej rreth 54 vjeç, kishte rezidentë me nacionalitete të ndryshme si: 43 shqiptarë, 8 serb, 5 ashkali, 1 maqedonas, 2 boshnjak.
4. Personeli i QIRSKP përbhet nga 39 persona, prej tyre, 1 psikiatër i cili është edhe drejtore i institucionit, 9 infermier, 12 ndihmës mjekësor, një punëtor social, pesë punëtor në kuzhinë si dhe pjesa tjetër në shërbime teknike, sigurim etj.

Legjislacioni relevant

5. Ligji i parë për Shëndetin Mendor, me Nr 05/L-025 i hyrë në fuqi në dhjetorë të vitit 2015, ka përqëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrrëgullime mendore. Neni 18 paragrafi 2, parashev nxjerrjen e aktit nënligjor për trajtimin e rezidentëve që gjenden në institucionet e kujdesit social¹. Gjithashtu, neni 34 i Ligjit për Shëndetin Mendor parashev nxjerrjen e akteve nënligjore të cilat duhet të jenë në pajtim me këtë ligj². Deri më tani nuk është nxjerr asnjë akt nënligjor.

Bashkëpunimi me MKPT gjatë vizitës

6. Gjatë vizitës së MKPT, personeli i QIRSKP-së i ofroi bashkëpunim të plotë ekipit monitorues. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat dhe iu mundësuan bisedat me

¹Neni 18, paragrafi 1 i Ligjit me Nr 05/L-025 Për Shëndetin Mendor, thekson: “Personave, që gjenden në institucionet rezidenciale të përkujdesit social, u ofrohet këshillim, trajtim, rehabilitim dhe kujdes në shëndet mendor në mënyrë të barabartë dhe sipas standardeve shëndetësore, të miratuara nga Ministra e Shëndetësisë”. Paragrafi 2 i këtij neni thotë: Mënyra e organizimit dhe e dhënies së shërbimeve, të parashikuara në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëgenies Sociale, të miratuar nga Qeveria.

²Neni 34.1 i Ligjit për Shëndetin Mendor: “Për zbatimin e këtij ligji, në afat brenda një (1) viti, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Qeveria e Kosovës dhe ministritë përkatëse nxjerrin aktet përkatëse nënligjore të cilat parashihen me këtë ligj”.

disa nga rezidentët të cilët ishin koshient dhe ishin në gjendje të komunikonin me ne, si dhe biseda u realizua pa prezencën e personelit të Qendrës.

Kushtet e jetesës së pacientëve dhe trajtimi

7. Qendra ishte e ndarë në 4 reparte (A1-A4). Në katin e parë ishte reparti A1, ku në të kaluarën ishte si seksion i rehabilitimit, tani në këtë repart ishin vendosur rastet që kërkojnë vëmendje të shtuar pasi ishin identifikuar si raste me ide suicidale, ndërsa reparti A4 ishte vetëm për gjininë femërore ku edhe dushet dhe tualetet ishin të ndara sipas gjinisë dhe kjo ishte mundësi e lehtë edhe për stafin për ti mbajtur nën kontroll rezidentët.

MKPT e vlerëson pozitivisht ristrukturimin e reparteve brenda Qendrës, si dhe kategorizimin e rezidentëve sipas gjinisë dhe nivelit të rrezikshmërisë, i cili ofron edhe siguri për rezidentët.

8. Krijimi i një mjedisi terapeutik pozitiv përfshinë vënien në dispozicion të hapësirës jetike të mjaftueshme për pacientë si: ndriçim, ngrohje, ajrim të përshtatshëm si dhe pastërti në nivel të kënaqshëm. Gjatë vizitës së MKPT-së në dhomat ku akomodoheshin rezidentët, kryesisht ishin 2 deri 3 shtretër në një dhomë, kishte ndriçim natyral dhe kryesisht ishin të ngrohta dhe të pastra, dhe ishin në pajtim me nenin 6, paragrafi 1.10 të Ligjit Nr.05/L-025 Për Shëndetin Mendorë.³
9. Sipas standardeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe dekorimit të dhomave të pacientëve dhe mjediseve të argëtimit, për tu dhënë pacientëve stimulim pamorë, gjithashtu vënia në dispozicion e komodinave pranë krevatit dhe gardërobave është shumë e dëshirueshme. Gjatë vizitës së MKPT-së, në dhomat e rezidentëve kishte komodina për vendosjen e rrobave dhe gjëra e personale, mirëpo rezidentët nuk kishin veshmbathje personale, pas çdo pastrimi ato ndërrohen mes rezidentëve, gjithashtu nuk kishte as dekorime për stimulim pamorë.
10. Gjithashtu MKPT u njoftua që në këtë Qendër janë duke e rinovuar lavanterin, e cila ishte e pajisur me makina të mëdha për larjen, tharjen dhe hekurosjen e rrobave, e çarçafëve.

Kuzhina

11. Gjatë vizitës në QIRSKP, ekipi i MKPT-së ka vizituar edhe kuzhinën ku përgatitet dhe servohet ushqimi. Kuzhina ishte në katin përdhese, nuk kishte ndriçim dhe ventilim të duhur, nyjet sanitare ishin shumë afër kuzhinës, ndërsa pastërtia ishte në nivel. Në vizitën e fundit MKPT vërejti se në sallën e ushqimit, ishin furnizuar me tavolina dhe karrige të reja.
12. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës rëndësi të veçantë i kushton edhe ushqimit të pacientëve, ushqimi jo vetëm që duhet të jetë i përshtatshëm nga pikëpamja e sasisë dhe cilësisë, por edhe të jepet në kushte të kënaqshme⁴. Gjatë vizitës, MKPT u njoftua që qendra është e furnizuar mirë dhe me rregull me ushqim, dhe se stafi i kuzhinës posedonin librezat sanitare. MKPT nuk ka hasur në ushqime me afate të skaduar. Në qendër ushqimi përgatitet sipas menysë dhe ju jepet në tri shujta. **MKPT përshëndet angazhimin e stafit për kujdesin dhe pastërtinë në kuzhinë. MKPT u**

³Neni 6, paragrafi 1.10 i Ligjit Nr.05/L-025 Për Shëndetin Mendorë, përcakton “të drejtën për t'u siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, higjenike, të ushqyerjes dhe sigurisë”

⁴ Normat e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga Raporti i 8-të i Përgjithshëm

rekomandon autoriteteteve relevante qe të ndërmarrin masat e duhura për ndërtimin e një kuzhine te re.

Trajtimi

13. Sipas Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, trajtimi psikiatrik duhet të bazohet në një përqasje të individualizuar, gjë që nënkupton hartimin e një plani trajtimi për çdo pacient, i cili plan duhet të përfshijë aktivitete rehabilituese dhe terapeutike, duke përfshirë psikoterapi individuale, terapi në grup, art, teatër, muzikë dhe sporte. Pacientët duhet të kenë qasje të rregullt në dhoma argëtimi të pajisura përshtatshëm dhe të kenë mundësi të bëjnë ushtrime ajrimi në qzell të hapur⁵.
14. Gjatë vizitës MKPT u njoftua se në QIRSKP aktivitetet psiko-sociale i kanë të reduktuara, për shkak të mungesës së repartit vokacional apo mbështetës, ku mund të realizohen aktivitetet rekreative. Sipas stafit të Qendrës, si aktivitet që rregullisht e bëjnë janë 2-3 ekskursione në vit, p.sh dalje në natyrë, shëtitje në ndonjë qytet turistik. MKPT konstaton se, në QIRSKP, trajtimi i ofruar rezidentëve konsiston kryesisht në farmakoterapi, ndërsa trajtimi rehabilitues psiko-social efektiv është i mangët. Kjo situatë është rezultat i mungesës së numrit të stafit si dhe mjedisit të përshtatshëm për realizimin e aktiviteteve. **MKPT rekomandon që në të ardhmen, Qendra të fokusohet në planifikimin e projektit për ndërtimin e njësisë vokacionale, si dhe angazhimin e një psikologu klinik dhe një punëtorë social shtesë.**

Kujdesi shëndetësor

15. MKPT u njoftua se, në QIRSKP ofrohen shërbime të rregullta psikiatrike, ku këto shërbime i kryen drejtori i Qendrës pasi që me profesion është psikiatër, ndërsa në rast nevoje, shërbimet tjera shëndetësore dhe specialistike u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Shtime, Spitali Rajonal në Ferizaj dhe Qendra Klinike Universitare në Prishtinë.
16. Qendra posedon ambulancën, e cila i plotëson kushtet për kryerjen e vizitave nga psikiatri si dhe kishte një sterilizatorë dhe pajisje për ndonjë intervenim të vogël kirurgjik apo lidhje plagësh.
17. MKPT ka vizituar 4 dhoma që ishin rregulluar brenda Qendrës falë donacioneve, ato dhoma do të shërbejnë për izolim të rasteve të evidentuara me ndonjë sëmundje ngjitime. MKPT u njoftua se disa rezidentëve ju kanë bërë testin për TBC, gjithashtu ekipi u informua se çdo vit bëhet vaksinimi kundër gripit. **MKPT rekomandon që rezidentëve të gjinisë femërore të ju ofrohen shërbime të rregullta gjinekologjike, si dhe të gjithëve të ju bëhen rregullisht analizat laboratorike.**
18. Qendra mban 19 regjistra, si: regjistri i narkomanëve, abuzimeve seksuale, lëndimeve trupore, vetlëndimeve, vetëvrasjeve, vdekjeve, regjistri i lëndimeve të punëtorëve të shkaktuara nga rezidentët, regjistri për analiza laboratorike, për vizita stomatologjike të kryera jashtë Qendrës, regjistri për sterilizim, vaksinim, regjistri për kontrolla psikiatrike dhe të përgjithshme, regjistri për lëndim dhe lidhje plagësh etj. **MKPT inkurajon stafin që në regjistra ngjarja përkatëse të përshkruhet më hollësish.**

⁵ Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga Raporti i 8-të i Përgjithshëm [CPT/Inf (98) 12]

Keqtrajtimi

19. Gjatë vizitës së MKPT-së në Qendër, vërehej një klimë pozitive dhe marrëdhënie të mira mes rezidentëve dhe stafit. **MKPT nuk ka evidentuar asnjë rast të torturës apo keqtrajtimit nga stafi ndaj personave me çrrregullime mendore.**
20. Gjatë kontrollimit të regjistrave, MKPT ka evidentuar numër të lartë të lëndimeve të rezidentëve, të cilat ishin rezultat i lëndimeve të rezidentëve me njëri-tjetrin, vetëlëndime si dhe lëndime të shkaktuara nga qentë endacak brenda rrrethojave të Institucionit. **MKPT rekomandon që të merren masat për evitimin e problemit të prezencës së qenve endacak në oborrin e Institucionit.**
21. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, thekson se është gjithashtu thelbësore që të ketë procedura të përshtatshme për të mbrojtur disa pacientë psikiatrikë nga pacientë të tjerë që mund t'u shkaktojnë dëm atyre. Kjo kërkon ndër të tjera një prani të përshtatshme personeli gjatë gjithë kohës, përfshirë natën dhe fundjavën⁶. **MKPT rekomandon që, përveç ndërtimit të njësisë vokacionale, duhet të rritet edhe numri i infermierëve, në mënyrë që stafi të kenë mundësi t'i mbajnë nën kontroll rezidentët.**

Mjetet e kufizimit

22. Sipas Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, kufizimi i pacientëve të axhituar ose të dhunshëm duhet të jenë, sa më shumë të jetë e mundur, jo fizike (p.sh instruksion gojor) dhe që aty ku është i nevojshëm kufizimi fizik, ai në parim duhet të kufizohet në kontroll me duar. Gjatë vizitës së MKPT-së, u intervistuan edhe stafi lidhur me çështjen e mjeteve kufizuese në raste të krizave, ku sipas tyre nuk përdoret asnjë mjet kufizimi, përveç mbajtjes me dorë në rastet kur ndonjëri nga rezidentët bëhet agresiv. Dhe në ato raste mblidhen të gjithë kujdestarët e natës, kërkijnë ndihmën nga psikiatri/drejtori apo e thërrasin emergjencën. **MKPT, gjatë vizitës nuk ka evidentuar raste të përdorimit të instrumenteve të kufizimit fizik, apo veçimit.**

Kontakti me botën e jashtme

23. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, thekson se mbajtja e kontakteve me botën e jashtme është thelbësore jo vetëm për parandalimin e keqtrajtimit por edhe nga një pikë vështrim terapeutik⁷. Gjatë vizitës, MKPT u njoftua se kohëve të fundit ka një shtim të vizitave familjare, gjithashtu kanë interesim dhe i marrin shpesht disa nga rezidentët gjatë festave, apo vikendeve. Ekzistojnë procesverbalet ku plotësohet nga stafi dhe nënshkruhet nga familja kur rezidenti shkon në shtëpi, gjithashtu familjarit i jepet edhe terapia me vete. MKPT u njoftua se 2 rezidentë të cilët ishin në fazën e remisionit, janë kthyer në familjet e tyre biologjike. E gjithë kjo është rezultat i angazhimit të stafit të Qendrës, të cilët mbajnë kontakte me familjarët, me Qendrat për Punë Sociale, duke i inkurajuar që të vinë më shpesht në vizita.
24. Secili rezidentë posedon skedarin për shfrytëzimin e pensioneve e cila menaxhohet nga punëtorja sociale e QIRSKP-së. Për shfrytëzimin e pensionit, ekziston komisioni prej 3

⁶ Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga Raporti i 8-të i Përgjithshëm [CPT/Inf (98) 12], *Parandalimi i keqtrajtimit*, paragrafi 30

⁷ Po aty, *Garanci gjatë vendosjes*, paragrafi 54

anëtarëve të cilët i verifikojnë blerjet dhe të gjitha pastaj i bashkëngjiten dosjeve të rezidentëve.

Procedura e parashtrimit të ankesave

25. Në QIRSKP, Institucioni i Avokatit të Popullit ka vendosur kutitë e ankesave, të cilat mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës. **MKPT nuk ka pranuar asnjëherë ankesa nga rezidentët apo familjarët e tyre. MKPT inkurajon stafin që të informoj më shumë familjarët e rezidentëve përmes mundësinës së parashtrimit të ankesave përmes kutive të vendosura në Qendër.**

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16 paragrafi 4 i Ligjit 05/L019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon:

Ministrinë e Shëndetësisë:


- Të nxjerrë aktet nënligjore në pajtim me Ligjin për Shëndetin Mendor.
- Të ndërmerr masa për ndërtimin e njësisë vokacionale në kuadër të QIRSKP-së.
- Të ndërmerr hapa për ndërtimin e kuzhinës së re.
- Të angazhohet në punë një psikolog klinik dhe një punëtorë social shtesë.
- Të rritet numri i infermierëve në këtë Qendër.

Komuna e Shtimes dhe QIRSKP:

- Të merren masat për evitimin e problemit të prezencës së qenve endacak në oborrin e Institucionit.

Qendra për Integrim dhe Rehabilitim të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime:

- Të ofrohen rezidentëve shërbime të rregullta gjinekologjike.
- T'u bëhen rezidentëve rregullisht analizat laboratorike.


Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit